

PJESA B: KONTRATA

Date 25.09.2020.

KUVENDI I KOMUNES DRAGASHI, (në vazhdim "Autoriteti Kontraktues"), në njëren anë; dhe

"U-UNIQUE" Sh.p.k-Prishtine (në vazhdim "Operatori Ekonomik"), ne anën tjetër, janë pajtuar të lidhin një kontratë publike për:

Punimi i nxemjes qendrore dhe renovimi i objektit të shkollës në fshatin Pllavë me numër Identifikues 621-20-4801-2-3-6, dhe nr te mbrendshem 621-2020-116-236

Neni 1 Lënda

1.1 Lënda e kontratës do të jetë **Punimi i nxemjes qendrore dhe renovimi i objektit të shkollës në fshatin Pllavë**

1.2 Kontrata hynë në fuqi me **25.09.2020.** dhe përfundon me **25.10.2020.**

1.3 Afati kohor i performances nuk mund të jetë më shumë se **2 ditë** nga data e marrjes së urdhëreses.

1.4 Vendi i [ekzekutimit të punëve] do të jetë **fshati Pllave-Dragash**

1.5 Incotermi i aplikueshëm do të jetë DDP¹ (Detyra e Dërguar e Paguar).

1.6 Menagjer i kontrates nga AK është: **Vloran Cenaj**

Menagjer i projektit nga AK është Vetim Hasani

Menagjer i projektit nga OE është Ulpian Tahiri

Neni 2 Ligji i aplikueshëm

2.1 Ligji i zbatueshëm do të jetë sipas Nenit 40 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092 Për çështjet

¹ DDP – Detyra e Dërguar e Paguar- Incoterms 2010 Oda Ekonomike Ndërkombëtare

që nuk mbulohen me dispozita të kontratës, zbatohen ligjet në fuqi në Kosovë. Juridiksioni do të jetë gjykata përkatëse në Prishtinë.

Neni 3 Çmimi

3.1 Çmimi total i kontratës do të jetë: **6,799.38 €**; (*gjashtë mij e shtatëqind e nentëdhjetë e nente Euro e tridhjetë e tete cent*).

3.2 Çmimi i përmendur në Nenin 3.1 më sipër duhet të jetë e vetmja pagesë që Autoriteti Kontraktues i ka borxh Operatorit Ekonomik sipas kontratës. Ai duhet të jetë i prerë dhe të mos i nënshtrohet ndryshimeve gjatë ekzekutimit të kontratës (në përjashtim të çmimeve të atyre artikujve që i nënshtrohen ndryshimit të çmimit sipas berzës përkatëse, nëse aplikohet).

Neni 4 Pagesat

4.1 Pagesa do të bëhet në Euro.

4.2 Pagesat e detyrimeve sipas një fature të lëshuar nga Operatori Ekonomik duhet të paguhet brenda jo më shumë se 30 ditësh nga data në të cilën kërkesa e pranueshme për pagesë është regjistruar nga departamenti përkatës. Data e pagesës do të jetë data në të cilën debitohet llogaria e institucionit. Kërkesa për pagesë nuk do të jetë e pranueshme nëse nuk plotësohen një ose më shumë nga kërkesat thelbësore.

Neni 5 Marrëveshjet lidhur me tatimin dhe doganën

5.1 Operatori Ekonomik është përgjegjës për të gjitha detyrimet dhe taksat në përputhje me Ligjin e Republikës së Kosovës.

5.2 Të gjitha taksat dhe detyrat e tjera doganore konsiderohen se janë të përfshira në çmimin e kontratës.

Neni 6 Kualiteti

6.1 Kualiteti i *[punëve]* duhet në të gjitha aspektet të plotësoj specifikimet teknike të parashtruara në Dosjen e Tenderit.

Neni 7 Garancioni

7.1 Garancioni do të mbetet valid për 12 muaj, pas pranimit të *[punëve]*.

Neni 8 Vonesat në ekzekutim

8.1 Nëse Operatori Ekonomik me përgjegjësinë e tij nuk arrin [te kryej ndonjë ose te gjitha punët] brenda limiteve kohore të specifikuara në kontratë, Autoriteti Kontraktues, pa njoftim zyrtar dhe pa paragjykim ndaj kompensimeve tjera të tij sipas kontratës, do të ketë të drejtë, për secilën ditë që kalon ndërmjet skadimit të periudhës së kontratës dhe datës aktuale të përfundimit, t'i marrë dëmet e likuiduara të barabarta me 0,25% në ditë të vlerës së [punëve] të pa dorëzuara deri në një maksimum prej 10 % të vlerës totale të kontratës.

Neni 9 Inspektimi dhe testimi

9.1 Autoriteti kontraktues do të ketë të drejtë që herë pas here të inspektojë, kontrollojë, masë dhe testojë komponentët, materialet, dhe mjeshtërinë, dhe të kontrollojë përparimin e përgatitjes, fabrikimit apo prodhimit të çfarëdo artikulli që përgatitet, fabrikohet ose prodhohet për t'u dorëzuar sipas kontratës, në mënyrë që të përcaktojë nëse komponentët, materialet dhe mjeshtëria kanë cilësinë dhe sasinë e kërkuar.

Neni 10 Nën-kontraktimi

10.1 Një nënkontratë do të jetë e vlefshme vetëm nëse është një marrëveshje me shkrim me të cilin Operatori Ekonomik i beson kryerjen e një pjese të kontratës së tij një pale të tretë. Operatori Ekonomik nuk duhet të nënkontrakttojë pa autorizim paraprak me shkrim nga Autoriteti Kontraktues. Autoriteti Kontraktues do të njoftojë Operatorin Ekonomik për vendimin e tij brenda 5 ditëve nga marrja e njoftimit, duke i paraqitur arsyet e veta nëse nuk lëshohet autorizimi.

Neni 11 Ndërprerja e Kontratës nga Autoriteti kontraktues

11.1 Autoriteti kontraktues mundet që, pasi t'i japë Operatorit Ekonomik shtatë ditë paralajmërim, ta ndërpresë kontratën në ndonjërin nga rastet në vijim: a) Kur operatori ekonomik nuk arrin t'i realizoj obligimet e veta sipas kontratës; b) Dështon në ekzekutimin e kontratës në afatin e caktuar; c). Refuzon urdhrat administrativ të autoritetit kontraktues; d) Ia jep dikujt kontratën apo nënkontratën pa autorizim nga autoriteti kontraktues; e). Falimenton; f). Është dënuar nga një gjykatë për një shkelje që ka të bëjë me sjellje profesionale, përmes një gjykimi që ka fuqinë e *res-judicata*; g) Operatori ekonomik i është nënshtruar një gjykimi që ka forcën e *res judicata* për mashtrim, korrupsion, përfshirje në ndonjë organizatë kriminale ose ndonjë aktivitet tjetër ilegal që i dëmton interesat e përgjithshme financiare; h) shfaqet ndonjë paaftësi tjetër ligjore që i pengon realizimit të kontratës.

Neni 12 Ndërprerja e Kontratës nga Operatori Ekonomik

12.1 Operatori Ekonomik, pasi e ka paralajmëruar Autoritetin Kontraktues 14 ditë paraprakisht, mund ta ndërpresë kontratën nëse Autoriteti kontraktues: a) Nuk arrin t'i paguajë Operatorin Ekonomik shumën që duhet të paguhet brenda periudhës së saktësuar me kontratë; b) vazhdimisht nuk arrin t'i plotësojë obligimet e veta me kontratë; c) si rezultat i forcës madhore, Operatori Ekonomik nuk është në gjendje për të kryer një pjesë materiale të kontratës për më shumë se 180 ditë, për arsye që nuk janë specifikuar në kontratë ose që nuk i atribuohen të Operatorit Ekonomik.

Neni 13 Zgjidhja e mosmarrëveshjeve me procedurë gjyqësore

13.1 Nëse nuk mund të arrihet zgjidhje brenda 30 ditësh nga fillimi i procedurës miqësore për zgjidhje të mosmarrëveshjes, secila palë mund të kërkojë ose vendim nga gjyqi, ose vendim arbitrimi.




13.2 Çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit të kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet në **Gjykatën Themelore në Prizrendega në Dragash** në pajtim me ligjin e Kosovës.

Neni 14 Komunikimi

14.1 Çdo komunikim me shkrim në lidhje me këtë Kontratë ndërmjet Autoritetit Kontraktues dhe Operatorit Ekonomik duhet jap Titullin e kontratës dhe numrin e identifikimit, dhe duhet të dërgohet me postë, faks, e-mail ose me dorë.


E hartuar në gjuhën [Shqip]² në tri origjinale, dy origjinale për Autoritetin Kontraktues dhe një original për Operatorin Ekonomik.

Për Operatorin Ekonomik		Për Autoritetin Kontraktues	
Emri:	“ U-UNIQUE” Sh.p.k- Prishtine	Emri:	Nuro Ismaili
Pozita:	<i>drejtor</i>	Pozita:	<i>Zyrtar përgjegjës për prokurim</i>
Nënshkrimi:		Nënshkrimi:	
Data:	25.09.2020.	Data:	25.09.2020.
Vula:		Vula:	

² Gjuha do të jetë gjuha e përdorur nga tenderuesi në tenderin e tij.

shkollu Pllavi
U-Unique

PARAMASA E PROJEKTI: Punimi i nxemjes qendrore dhe renovimi i objektit të shkollës në fshatin Pllavë					
A PUNËT PËRGATITORE					
	Përshkrimi i punimeve	Njësia	Sasia	Çmimi	Totali
1	Punëmarrësi është i detyruar që para fillimit të punimeve të bëjë rrethimin e punishtës, t'i montoj barakat montazhe (kontejnerët) për punëtorët dhe organin mbikqyrës. Pas përfundimit të punimeve të njëjtat duhet të largohen dhe të bëhet pastrimi i objektit dhe terrenit rreth objektit në tërësi.	komplet	1	50.00	50.00 €
2	Furnizimi me ambalazh mbrojtës dhe paketimi me kujdes i gjesendeve me vlerë në zonë ku do të rinovohet, duke përfshirë bartjen dhe lëvizjen e mobiljeve ekzistuese duke u kujdesur që mos lëndohen dhe kthehen në gjendjes të mëparshme pas përfundimit të punimeve. Mobiliet si dhe gjerat me vlerë të ambalazuara gjatë kryerjes së punimeve duhet të depozitohen (Magazinohen) në zonë të sigurtë. Vërejtje: Çdo dëmtim eventual të gjerave me vlerë të orendive gjatë zhvendosjes/lëvizjes nga pakujdesia e punëtorve mbetet përgjegjësi e Operatorit Ekonomik që ta kompenzoj dëmin.	komplet	1	50.00	50.00 €
Gjithsej punët përgatitore:					100.00 €
B PUNËT E DEMOLIMIT					
	Përshkrimi i punimeve	Njësia	Sasia	Çmimi	Totali
Punëmarrësi është i detyruar që të gjitha materialet e demoluara (sipas pos. të poshtëshënuara) t'i largojë nga punishtja apo t'i transportojë deri në deponinë e caktuar për deponim materiale. Materialet që i nevoiten Autoritetit Kontraktues duhet të deponohen në depot e parapara për grumbullim të materialit në depot e Komunës.					
2	Demolimi i dyshemes ekzistuese nga materiale të ndryshme (Drrasa, Linoleum, Qeramike etj.) në cmim të llogaritet edhe bartja e materialit deri në deponi legale	m²	297.75	0.50 €	148.88 €
Gjithsej punët e demolimit					148.88 €



C PUNËT E DYSHEMESË					
Përshkrimi i punimeve		Njësia	Sasia	Çmimi	Totali
1	Furnizimi, transportimi, punimi i shtresës rrafshuese me beton gjysëm të terur (Estrih Beton) me trashësi (4-5) cm min. Në çmim të llogaritet edhe shtresat nga stiropori i presuar N4 me trashësi 5cm (3+2) si dhe PVC folia 2 mm.	m ²	297.75	7.00 €	2,084.25 €
2	Furnizimi me material dhe punimi i dyshemese me pllaka nga graniti artificial (Porcelani) me t=1.0 deri 2.0 cm, ne cmime te llogaritet edhe ngjitësi, fuga dhe coklla ne tere perimetrin e mureve nga i njejt material.	m ²	297.75	15.00 €	4,466.25 €
Gjithsej punët e dyshemesë:					6,550.50 €
RENOVIMI I SHMFU RENOVIMI I SHKOLLËS FILLORE NË FSHATIN					
RE KAPITULIM I P UNIMEVE					
A	PUNËT PËRGATITORE				
B	PUNËT E DEMOLIMIT				100.00 €
C	PUNËT E DYSHEMESË				148.88 €
GJITHSEJ PUNËT NDËRTIMORE ME TVSH				6,550.50 €	
					6,799.38 €

